

DEKRET
Nr.6201, datë 8.6.2009

**PËR CAKTIMIN E KOMPETENCAVE TOKËSORE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE
GJYQËSORE DHE TË QENDRËS SË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË TË SECILËS
PREJ TYRE**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, paragrafi 3 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjykatat e rretheve gjyqësore organizohen në 22 rrethe gjyqësore, me kompetencë tokësore dhe qendra të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë:

- 1.Gjykata e rrethit gjyqësor Berat, me kompetencë tokësore në rrethet Berat, Skrapar e Kuçovë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Berat.
- 2.Gjykata e rrethit gjyqësor Dibër, me kompetencë tokësore në rrethet Bulqizë e Dibër dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Peshkopi.
- 3.Gjykata e rrethit gjyqësor Durrës, me kompetencë tokësore në rrethin Durrës dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin e Durrësit.
- 4.Gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan, me kompetencë tokësore në rrethet Elbasan, Gramsh, Librazhd e Peqin dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Elbasan.
- 5.Gjykata e rrethit gjyqësor Fier, me kompetencë tokësore në rrethet Fier e Mallakastër dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Fier.
- 6.Gjykata e rrethit gjyqësor Gjirokastrë, me kompetencë tokësore në rrethet Gjirokastrë e Tepelenë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Gjirokastrë.
- 7.Gjykata e rrethit gjyqësor Kavajë, me kompetencë tokësore në rrethin Kavajë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Kavajë.
- 8.Gjykata e rrethit gjyqësor Korçë, me kompetencë tokësore në rrethet Devoll, Kolonjë e Korçë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Korçë.
- 9.Gjykata e rrethit gjyqësor Krujë, me kompetencë tokësore në rrethin Krujë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Krujë.
- 10.Gjykata e rrethit gjyqësor Kukës, me kompetencë tokësore në rrethet Kukës e Has dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Kukës.
- 11.Gjykata e rrethit gjyqësor Kurbin, me kompetencë tokësore në rrethin Laç dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Laç.
- 12.Gjykata e rrethit gjyqësor Lezhë, me kompetencë tokësore në rrethet Lezhë e Mirditë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Lezhë.
- 13.Gjykata e rrethit gjyqësor Lushnjë, me kompetencë tokësore në rrethin Lushnjë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Lushnjë.
- 14.Gjykata e rrethit gjyqësor Mat, me kompetencë tokësore në rrethin Mat dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Burrel.
- 15.Gjykata e rrethit gjyqësor Përmet, me kompetencë tokësore në rrethin Përmet e në bashkinë Leskovik dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Përmet.
- 16.Gjykata e rrethit gjyqësor Pogradec, me kompetencë tokësore në rrethin Pogradec dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Pogradec.
- 17.Gjykata e rrethit gjyqësor Pukë, me kompetencë tokësore në rrethin Pukë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Pukë.
- 18.Gjykata e rrethit gjyqësor Sarandë, me kompetencë tokësore në rrethet Delvinë e

Sarandë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Sarandë.

19.Gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër, me kompetencë tokësore në rrethet Malësi e Madhe dhe Shkodër dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Shkodër.

20.Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, me kompetencë tokësore në rrethin Tiranë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Tiranë.

21.Gjykata e rrethit gjyqësor Tropojë, me kompetencë tokësore në rrethin Tropojë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Bajram Curri.

22.Gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë, me kompetencë tokësore në rrethin Vlorë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Vlorë.

Neni 2

Për efekt të zbatimit të këtij dekreti, në rrethin Kolonjë nuk përfshihet bashkia Leskovik.

Neni 3

Dekreti 5350, datë 11.6.2007 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”, shfuqizohet.

Neni 4

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi më 1 shtator 2009.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi